



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 376 prot.

Kuçovë më 29.12.2022

VENDIM

Nr. 82, datë 22.12.2022

“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT PER ZBATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE BASHKIAKE,2019–2025”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 3, nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1,1, nenit 23 pika 10, nenit 54, nenit 55 pikat 2,3 dhe 6, të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 12 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”; Ligjit nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjin nr.8094, datë 21.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”; VKM nr. 418/2020, “Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”; VKM nr. 671/2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, në funksion dhe në përmbushje të kuadrit ligjor mjedisor; VKM nr.418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; VKM nr.608, datë 17.09.2014, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”; VKM nr.319, datë 31.05.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”; VKM nr. 402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”; VKM nr. 957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfill-et e mbetjeve” ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018”; VKM nr. 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”; VKM nr.177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”; VKM nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet ngapajisjet elektrike dhe elektronike”; Vendim i KKT nr.1, Datë 13.01.2020 “ Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”; VKM nr. 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddepozitimeve të mbetjeve urbane”; VKM nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin përmbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”; Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të

trajtimin të mbetjeve të ngurta urbane”; VKB nr. 43, datë 21.05.2019 “Për Miratimin e Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta Bashkiake, 2019–2025”; Këshilli i Bashkisë mori në shqyrtim “Raportin e Vlerësimit Afat mesëm të Zbatimit të Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta Bashkiake, 2019–2025” të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta Bashkiake, 2019–2025 (Plani MIMNB), synon zbatimin e Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në nivel vendor, dhe është në përputhje me kornizën ligjore të miratuar me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta”. Plani përcakton vizionin, qëllimet, objektivat, dhe rezultatet e shënjestrat e synuara, për aspektet e menaxhimit të mbetjeve për një periudhë 6 vjeçare, si dhe përcakton treguesit e performancës për matjen e arritjes së objektivave dhe të ecurisë së rezultateve.

Plani përmban masat përperiudhën 2019–2025, fondet e parashikuara për zbatimin e këtyre masave, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve duke vendosur një theks të veçantë mbi bashkëpunimin mes Bashkisë Kuçovë dhe institucioneve në nivel qendror, komunitetit, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Mbas një periudhe tre vjeçare të zbatimit të Planit MIMNB, Kryetari i Bashkisë inicioi një proces vlerësimi afatmesëm të zbatimit të Planit. Ky vlerësimi u realizua nga Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG), në kuadër të projektit *Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit*, dhe u realizuar në periudhën Mars–Shtator 2022.

Qëllimi i vlerësimit ishte të vlerësonte statusin e zbatimit afatmesëm të Planit MIMNB, nivelin e arritjes së objektivave të Planit, si dhe të evidentonte arritjet e tre viteve të para të Planit në raport me rezultatet e pritshme, përkundrejt treguesve të performancës të përcaktuara në Plan, duke verifikuar kështu nëse masat janë zbatuar dhe rezultatet janë arritur, siç janë paraparë. Gjatë procesit të vlerësimit janë identifikuar vështirësitë dhe sfidat e ndeshura nga bashkia dhe partnerët e bashkëpunëtorët përgjatë zbatimit të Planit, mësimet e nxjerra, si dhe rekomandime për mënyrën e kapërcimit të sfidave dhe adresimit të nevojave në të ardhmen.

Raporti i vlerësimit të zbatimit të Planit i paraqet Këshillit të Bashkisë informacion mbi rezultatet e politikës së miratuar prej tij në lidhje me shërbimet MIMNB dhe efektet e vendimmarrjes së Këshillit përgjatë tre viteve të zbatimit të Planit. Gjithashtu raporti ka si qëllim të orientojë Këshillin për vendimmarrjet e ardhshme për të përshtatur Planin me VKM nr. 418/2020, “Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”, me Vendimin e KKT nr. 1, Datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, si dhe me ndryshimet dhe plotësimet në legjislacionin sektorial në fushën e MIMNB.

Raportin e informacionit të strukturuar mbi progresin e zbatimit të Planit si në termat e arritjes së objektivave dhe rezultateve në tërësi, ashtu edhe përsa i përket progresit në zbatimin e masave që parashikonte Plani, fondeve të alokuara dhe aktorëve të angazhuar në zbatimin e

masavetë Planit. Përmes vlerësimit, raporti identifikon mangësitë dhe sfidat kryesore dhe praktikatat e mira të përjetuara, çdo mësim të nxjerrë, sidhë rekomandime për të përmirësuar Planin.

Mbas diskutimeve dhe shqyrtimit të raportit në mbledhjen e këshillit bashkiak, dhe përsamësi për, Këshilli i Bashkisë Kuçovë;

VENDOSI

1. Të miratojë "Raportin për Vlerësimin e Zbatimit A fatmesëm të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Kuçovë, 2019–2025, për periudhën 2019–2022", sipas raportit bashkëngjitur dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Përndjekjen e rekomandimeve të raportit dhe të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Shërbimeve Publike.
3. Ngarkohet Sekretarii i Këshillit Bashkiak të publikojë raportin në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Kuçovë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55, pika 6.

Ky vendim u miratua me 16 vota pro, — vota kundër, — vota abstenim në prezencë të 16 këshilltarëve.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

/ Migena BULLARI

